Esta apostilla certifica solo la calidad del firmante así como la autenticidad de su misma firma. No certifica el contenido del documento para el que se emite.

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**REPUBLIKA E ITALISË**

Sot më, 20 Janar 2015 në Romë, në studion time me adresë në Rrugën "Ugo Ojetti" Nr. 54

(20 Janar 2015)

Përpara meje Dr. Paolo Pistelli, nofer në Romë, i regjistruar ne Dhomën e Noterisë së Rretheve të Bashkuara të Romës, Velletri dhe Civitavecchia.

U paraqiten:

**SPEDALE Roberto**, lindur në Palermo më 11 Janar 1977, banues në Cori (LT), Frazione Giulianello, Rruga "Della Stazione" numer 31, kodi fiscal SPD RRT 77A01 G273Y; DHE

**RICCI Renzo**, lindur në Romë më 26 Janar 1955 dhe banues në Rruga "Cipriano Facchinetti" numer 113, kodi fiscal RCC RNZ 55A26 H501D.

Palët, qytetarë italianë, për identitetin e të cilëve unë noteri jam i sigurtë, me këtë akt pajtohen dhe përcaktojnë si më poshtë vijon:


NENI 1) Zotérinjtë Spedale Roberto dhe Ricci Renzo do të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar të quajtur "DUEERRE S.R.L" në formë të shkurtuar "2R S.R.L", me seli ne Romë, Rruga Prenestina numer 697.

NENI 2) Kapitali fillestare është 100.000 (njëqind mijë) Euro dhe është nënshkruar nga Z. RICCI Renzo per një kuotë prej 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) Euro dhe nga Z. SPEDALE Roberto për një kuotë prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) Euro.

NENI 3) Shoqëria dëklarohet e themeluar në përputhje të plotë të normave në përbajtje të këtij akti dhe të atyre të parashikuara në Statutin e shoqërisë që palët paraqiten, bashkëngjitur si aneksi "A", pasi u lexua prej meje Noterit.

NENI 4) Shoqëria ka si objekt aktiviteti:

- zhvillimin, prodhimin, tregtimin, qiradhëni dhe asistencën teknike (vetjake ose për llogari të të tretëve) në fushën e mekanikës, elektromekanikës, telekomunikacionit, audio-video dhe të elektronikës në përgjithësi dhe në veçanti makinat CNC të çfarëdo tipi apo natyre;



- veprimitari në ciklin e plotë të inovacionit: nga kërkimet industriale deri në zhvillimin eksperimental, në realizimin e prototipave dhe demonstruesve edhe në ambiente prodhimi, në realizimin inxhinierik të prototipeve, ne aktivitetin e asistencës teknike dhe konsulencës, në adoptimin e teknologjisë nga ana e klientëve dhe partnerëve. Këto aktivitete mund të zhvillohen në sektore të ndryshëm teknologjike të mundësuara si fotonika, sistemet e avancuara të prodhimit, nano dhe mikro elektronika, përbërjet e avancuara, teknologjitet e informacionit dhe të telekomunikacionit duke i adresuar në një treg të përbërë nga një shumicë fushash produktive dhe ekonomike si përsimbull: prodhimin, mekanikën dhe mekatronikën, ajrore dhe të transportit, agroindustriale, biomjekësore, energjitike dhe ambientale;
- inkurajon përhapjen e përdorimit të mjeteve dixhitale të prototipizimit dhe te dizajneve të hapura, të vleresojne prodhimin artizanal vendas, te realizojnë me metoda tradicionale ose nepermjet përdorimit teknologjive dixhitale (duke marrë parasysh parimet e eko-dizajnit dhe ndarjen e praktikës së ripërdorimit të produkteve dhe materialeve të riciklimit);
- ndërtimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave, adresa internet dhe portale, hosting, housing dhe asistencë të vazhdueshme;
- shitje dhe realizimin e sherbimeve te internetit, intranet, extranet, e-commerce, internet në linjë të ndërrueshme dhe linjë të dedikuar;
- konsultime multimediale dhe grafike duke përfshirë krijimin e markave dhe logove;
- blerjen e know how ose te patentave dhe vleresimin e rezultateve te kerkimeve dhe patentave të përllogaritura në kryerjen e biznesit të tyre;
- furnizimin e sherbimeve për aplikimin, organizimin dhe zhvillimin e teknologjive të informacionit;
- projektimin dhe planifikimin e sistemave informatike që përfshijnë harduerët e kompjuterave, softwerët dhe teknologjitet e komunikimit;
- projektimin dhe zhvillimin e softwerëve dhe asistencave të ndryshme;
- kërkime dhe zhvillime relative të projekteve me permajtje të lartë teknologjike/inovative, që synojne mbajtjen e financimeve dhe shitjeve, nga ana e Bashkimit European dhe të organizmave te tjere publike ose private.

Në fushen e kreativitetit shoqëria merret me:

- ideimin, realizimin dhe menaxhimin e laboratoreve për studentet e rinj, të diplomuar ose eksperte per vlerësimin e parë të ideve inovative te produkteve të reja ose sherbimeve dhe për kuptimin e shkallës së vlerësimit produktiv të tyre;
- në veçanti organizimin e workshopave, konkurseve, seminareve, konferencave duke u zgjeruar nga dizajni në arkitekturë, në prototipizimin elektronik, në realizimin e ambienteve dhe produkteve nderaktive, me qëllim zhvillimin e njohurive.
- aktivitetin publicitar në përgjithesi edhe në formen e shkëmbimeve me cdo mjet informacioni dhe komunikacioni, me cdo teknologji të lidhur; organizimin e eveneve, panaireve, manifestimeve,



- fushatave të sponsorizimit dhe promocioneve, menaxhimin e buxhetit të publicitetave, si dhe ne përgjithësi aktivitetin e promocioneve, në cfarëdo forme dhe me cfarëdo mjeti, të veprimtarive tregtare;
- mbledhjen, menaxhimin, shpërndarjen e të dhënave, si dhe tregtimin e mallrave dhe shërbimeve përmes mjeteve të komunikimit dhe platformave të të gjitha llojeve, në vecanti krijimin e një platforme për të prezantuar produkte dhe projekte dixhitale në vetvete ose të prodhua me procese inovative.
  - veprimtari grafike dhe editoriale të prodhimit dhe tregtisë, të gazetave (me përjashtim të të perditshmeve), periodike, (blog / forum), produkte, shërbimet editoriale që lidhen me informacionin dhe komunikimin në përgjithësi, të çdo lloji dhe forme, me çdo mjet dhe teknologji dhe nëpermjet cdo platforme, të realizuar me cdo suport, në letër ose jo (funkSIONALE PËR SHPËRNDARJEN E REZULTATEVE TË AKTIVITETEVE TË TRAJNIMIT DHE KËRKIMIT).

Shoqëria ka gjithashtu si objekt, per vete ose për llogari të te treteve, furnizimin e shërbimeve, edhe ne sektorin e avancuar të shërbimeve, të drejtpërdrejtë dhe për të nxitur zhvillimin dhe realizimin e menaxhimit te biznesit.

Në veçanti, aktiviteti i shoqërisë është i drejtar në ofrimin e shërbimeve:

- informative, konsulence dhe asistence të bizneseve për përmiresimin dhe kontrollin e cilësisë dhe për formimin profesional;
- realizimin, blerjen e aksioneve; performancën e menaxhimit, administrimit, të studimit, kërkimit dhe të analizimit në çështjet ekonomike, financiare dhe industriale. Në veçanti, ajo operon në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim inkurajimin e krijimit të iniciativave inovative;
- Në përballjen me të tretët për prototipizimin ose realizimin e projekteve në mënyrën dhe qëllimet që do të bien dakord midis palëve.

Për më tepër, mund të kryejë aktivitete si:

- import dhe eksport, tregti me shumicë dhe pakicë në llogari të vet dhe në emër të palëve të treta, me depozitë dhe/ose pa, shitje dhe mirëmbajtje e pajisjeve të çdo lloji dhe specie dhe në veçanti të: artikujve shkollore, librave, materialeve përfurnizim zyre, elektronikë, TV dhe wifi, kompjutera personalë, transmetim, sisteme priti je satelitore dhe tokësore, kompjutera elektronikë, komponentë harduer dhe programe softuerësh, artikuj për ndriçim dhe materiale të ndryshme elektrike, komponentë elektronikë, telefona të të gjitha llojeve dhe aksesorëve, pajisje shtëpiake, robotë, produkte bukurie, produkte optikë dhe fotografie, pajisje shtëpiake, artikuj përfdhurata, mobilje zyre, dizajnin e pajisjeve shtëpiake, kondicionimi dhe ngrohja, produktet dhe artikujt për të prodhuar energji të pastër, sisteme energjie inovative dhe që kursejnë energji (panele djellore, turbinat e eres etj), artikuj per zhytje, lojera, motorre, bicikleta, , pjese kembimi te te gjitha aksesoreve te mesiperme, artikuj sportive per kohen e lire, produkte sanitare, dyqan hardware, kopshtar, motorre (përfshirë makinat, automjetet industriale, motorre, varka etj.)



- import dhe eksport, si dhe tregti me shumice dhe pakicë, në të gjitha format e lejuara nga ligji, të produkteve të lidhura me aktivitetin e shoqërisë si dhe tregtine e tyre elektronike.

Shoqëria ka të drejtë që në Itali ose jashtë saj të hapë ose të mbyllë seli dytesore, degë, zyra, depozita, fabrika, përfaqësi të ngjashme dhe të punësoje për çdo produkt ose markë nga cdo kompani qofte edhe e huaj, koncessionet, komisionet dhe mandatet me ose pa depozitë.

Shoqëria mund të blejë ose të shesë aksione në kompani, ente ose shoqëri (të themeluara ose në themelim) që kanë një objekt të ngjashëm me të vetin.

Si përfundim, shoqëria mundet të kryejë të gjitha transaksionet industriale, që kanë të bëjnë me pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme dhe financiare që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për të përmbushur objektin e kësaj shoqërie, përfshire këtu sic u permend më lart, marrjen e interesave dhe aksioneve, direkte ose indirekte, në shoqëri ose kompani të tjera me objekt të ngjashëm, e lidhur gjithashtu dhe me sigurimin e garancive reale ose personale në favor të tretëve, me kusht që të mos përbejë veprimtarinë e saj kryesore dhe të mos jetë në kundërshtim me dispozitat e ligjit D.L.gj. 385/1993.

NENI 5) Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është deri më 31 dhjetor 2100.

NENI 6) Palët bien dakort që aktualisht shoqëria të administrohet nga administratori i vetëm i cili do të jetë ortaku RICCI Renzo, me gjeneralitetet e sipërcituara, që do të ketë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqerise, duke e përfaqësuar ligjërisht me të tretët dhe që do të qëndrojë në detyrë deri në revokim ose dorëheqje.

NENI 7) Palët i drejtohen organit të administrimit të sipërcituar, i cili pranon marrjen dhe lëshon një faturë për 25% të kuotës së gjithësecilit të nënshkruar nga: Z. SPEDALE Roberto, përmes çekut n. 6510106656-03 me vlerë 3750 (tre mijë e shtatëqind e pesëdhjete) Euro, lëshuar me datë 20 Janar 2015 nga Banka "Sella" S.P.A., Agjencia 7 në Romë, dhe Z. RICCI Renzo përmes çekut n. 7200105029-00 në vlerën 21.250 (njëzet e një mijë e dyqind e pesëdhjetë) Euro, lëshuar me datë 19 Janar 2015 nga "Banka Popullore" në Bergamo, Agjencia 126 në Romë.

NENI 8) Viti finanziar mbylljet me 31 dhjetor të çdo viti. Viti i parë do të mbylljet me 31 dhjetor 2015.

NENI 9) Shpenzimet për themelimin në Shumën 1800 (një mijë e tetëqind) Euro janë në ngarkim të shoqërisë.

Këtë akt ia lexova palëve, të cilët e miratojnë dhe e nënshkruajnë në praninë time në orën 14:50.

Ky akt, i shkruar nga një person që gjëzon besimin tim dhe redaktuar prej meje përbëhet nga tre fletë dhe nëntë faqe deri këtu.



Firmosin

SPEDALLE Roberto; RICCI Renzo; Noteri Paolo PISTILLI.

Vula e Noterit



**ANEKSI "A" ME NUMER REP. 37.540 DHE KOL. 11.407**

**STATUT**

1. Themelohet një shoqëri me perjegjësi të kufizuar e quajtur **DUEERRE S.R.L** në formë të shkurtuar **2R S.R.L.**
2. Shoqeria e ka selinë në Romë. Transferimi i selisë brënda të njëjtë qytet vendoset nga organi administrativ.
3. Shoqëria ka si objekt:
  - zhvillimin, prodhimin, tregtimin, qiradhënien dhe asistencën teknike (vetjake ose për llogari të të tretëve) në fushën e mekanikës, elektromekanikës, telekomunikacionit, audio-video dhe të elektronikës në përgjithësi dhe në veçanti makinat CNC të çfarëdo tipi apo natyre;
  - veprimitari në ciklin e plotë të inovacionit: nga kërkimet industriale deri në zhvillimin eksperimental, në realizimin e prototipave dhe demonstruesve edhe në ambiente prodhimi, në realizimin inxhinierik të prototipeve, ne aktivitetin e asistencës teknike dhe konsulencës, në adoptimin e teknologjisë nga ana e klientëve dhe partnerëve. Këto aktivitete mund të zhvillohen në sektore të ndryshëm teknologjike të mundësuara si fotonika, sistemet e avancuara të prodhimit, nano dhe mikro elektronika, përbërjet e avancuara, teknologjite e informacionit dhe të telekomunikacionit duke i adresuar në një treg të përbërë nga një shumicë fushman produktive dhe ekonomike si përshembull: prodhimin, mekanikën dhe mekatronikën, ajrore dhe të transportit, agroindustriale, biomjekësore, energjitetikë dhe ambientale;
  - inkurajon përhapjen e përdorimit të mjeteve dixhitale të prototipizimit dhe te dizajneve të hapura, të vleresojne prodhimin artizanal vendas, te realizojnë me metoda tradicionale ose nepermjet përdorimit teknologjive dixhitale (duke marrë parasysh parimet e eko-dizajnit dhe ndarjen e praktikës së ripërdorimit të produkteve dhe materialeve të riciklimit);
  - ndërtimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave, adresa internet dhe portale, hosting, housing dhe asistencë të vazhdueshme;
  - shitje dhe realizimin e sherbimeve te internetit, intranet, extranet, e-commerce, internet në linjë të ndërrueshme dhe linjë të dedikuar;
  - konsultime multimediale dhe grafile duke përfshirë krijimin e markave dhe logove;
  - blerjen e know how ose te patentave dhe vleresimin e rezultateve te kerkimeve dhe patentave të përllogaritura në kryerjen e biznesit të tyre;
  - furnizimin e sherbimeve për aplikimin, organizimin dhe zhvillimin e teknologjive të informacionit;
  - projektimin dhe planifikimin e sistemeve informatike që përfshijnë harduerët e kompjuterave, softwerët dhe teknologjitet e komunikimit;
  - projektimin dhe zhvillimin e softwerëve dhe asistencave të ndryshme;



- kërkime dhe zhvillime relative të projekteve me permbajtje të lartë teknologjike/inovative, që synojne mbajtjen e financimeve dhe shitjeve, nga ana e Bashkimit European dhe të organizmave të tjera publike ose private.

Në fushen e kreativitetit shoqëria merret me:


- ideimin, realizimin dhe menaxhimin e laboratoreve për studentet e rinj, të diplomuar ose eksperte për vlerësimin e parë të ideve inovative të produkteve të reja ose sherbimeve dhe për kuptimin e shkallës së vlerësimit produktiv të tyre;
- në veçanti organizimin e workshopave, konkurseve, seminareve, konferencave duke u zgjeruar nga dizajni në arkitekturë, në prototipizimin elektronik, në realizimin e ambienteve dhe produkteve interaktive, me qëllim zhvillimin e njohurive.
- aktivitetin publicitar në përgjithësi edhe në formen e shkëmbimeve me cdo mjet informacioni dhe komunikacioni, me cdo teknologji të lidhur; organizimin e eventeve, panaireve, manifestimeve, fushatave të sponsorizimit dhe promocioneve, menaxhimin e buxhetit të publicitetave, si dhe ne përgjithësi aktivitetin e promocioneve, në cfarëdo forme dhe me cfarëdo mjeti, të veprimitarive tregtare;
- mbledhjen, menaxhimin, shpërndarjen e të dhënave, si dhe tregtimin e mallrave dhe shërbimeve përmes mjeteve të komunikimit dhe platformave të të gjitha llojeve, në vecanti krijimin e një platforme për të prezantuar produkte dhe projekte dixhitale në vetvete ose të prodhuara me procese inovative.
- veprimitari grafike dhe editoriale të prodhimit dhe tregtisë, të gazetave (me përjashtim të të perditshmeve), periodike, (blog / forum), produkte, shërbimet editoriale që lidhen me informacionin dhe komunikimin në përgjithësi, të çdo lloji dhe forme, me çdo mjet dhe teknologji dhe nëpermjet cdo platforme, të realizuar me cdo suport, në letër ose jo (funkSIONALE PËR SHPËRNDARJEN E REZULTATEVE TË AKTIVITETEVE TË TRAJNIMIT DHE KËRKIMIT).

Shoqëria ka gjithashtu si objekt, per vete ose për llogari të te treteve, furnizimin e shërbimeve, edhe ne sektorin e avancuar të shërbimeve, të drejtpërdrejtë dhe për të nxitur zhvillimin dhe realizimin e menaxhimit te biznesit.

Në veçanti, aktiviteti i shoqërisë është i drejtuar në ofrimin e shërbimeve:

- informative, konsulencë dhe asistencë të bizneseve për përmiresimin dhe kontrollin e cilësisë dhe performimin profesional;
- realizimin, blerjen e aksioneve; performancën e menaxhimit, administrimit, të studimit, kërkimit dhe të analizimit në çështjet ekonomike, financiare dhe industriale. Në veçanti, ajo operon në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim inkurajimin e krijimit të iniciativave innovative në përbaljen me të tretët për prototipizimin ose realizimin e projekteve në mënyrën dhe qëllimet që do të bien dakord midis palëve.

Për më tepër, mund të kryejë aktivitete si:



- import dhe eksport, tregti me shumicë dhe pakicë në llogari të vet dhe në emër të palëve të treta, me depozitë dhe/ose pa, shitje dhe mirëmbajtje e pajisjeve të çdo lloji dhe specie dhe në veçanti të: artikujve shkolllore, librave, materialeve për furnizim zyre, elektronikë, TV dhe wifi, kompjutera personalë, transmetim, sisteme pritjeje satelitore dhe tokësore, kompjutera elektronikë, komponentë harduer dhe programe softuerësh, artikuj për ndriçim dhe materiale të ndryshme elektrike, komponentë elektronikë, telefona të të gjitha llojeve dhe aksesorëve, pajisje shtëpiake, robotë, produkte bukurie, produkte optikë dhe fotografie, pajisje shtëpiake, artikuj për dhurata, mobilje zyre, dizajnin e pajisjeve shtëpiake, kondicionimi dhe ngrohja, produktet dhe artikujt për të prodhuar energji të pastër, sisteme energjje inovative dhe që kursejnë energji (panele djellore, turbinat e eres etj), artikuj per zhytje, lojera, motorre, bicikleta, , pjesë kembimi te te gjitha aksesoreve te mesiperme, artikuj sportive per kohen e lire, produkte sanitare, dyqan hardware, kopshtar, motorre (përfshirë makinat, automjetet industriale, motorre, varka etj.)
- import dhe eksport, si dhe tregti me shumice dhe pakicë, në të gjitha format e lejuara nga ligji, të produkteve të lidhura me aktivitetin e shoqërisë si dhe tregtine e tyre elektronike.

Shoqëria ka të drejtë që në Itali ose jashtë saj të hapë ose të mbyllë seli dytesore, degë, zyra, depozita, fabrika, përfaqësi të ngjashme dhe të punësoje për çdo produkt ose markë nga cdo kompani qofte edhe e huaj, koncensionet, komisionet dhe mandatet me ose pa depozitë.

Shoqëria mund të blejë ose të shesë aksione në kompani, ente ose shoqëri (të themeluara ose në themelim) që kanë një objekt të ngjashëm me të vetin.

Si përfundim, shoqëria mundet të kryejë të gjitha transaksionet industriale, që kanë të bëjnë me pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme dhe financiare që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për të përbushur objektin e kësaj shoqërie, përfshire këtu sic u permend më lart, marrjen e interesave dhe aksioneve, direkte ose indirekte, në shoqëri ose kompani të tjera me objekt të ngjashëm, e lidhur gjithashtu dhe me sigurimin e garancive reale ose personale në favor të të tretëve, me kusht që të mos përbejë veprimtarinë e saj kryesore dhe të mos jetë në kundërshtim me dispozitat e ligjit D.L.gj. 385/1993.

#### 4. Afati i veprimitarisë së shoqërisë është deri më 31 dhjetor 2100.

Ky afat mund te zgjatet me vendim asambleje të miratuar nga shumica e ortakeve. Nëse zgjatja e afatit aprovohet para skadimit nuk jep të drejtën e térheqjes.

#### 5. Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Euro.

6. Mund të ndahan të gjitha elementet e aktivit që janë subjekt i vlerësimit ekonomik dhe në vecanti të mira në natyre, kredite, ofrim punimesh ose shërbimesh në favor të shoqërise. Pjesmarja e ortakeve edhe gjate rritjes se kapitalit te shoqerisem mund te percaktohet ne një menyre jo proporcionale me kontributet.



7. Kuotat janë të ndashme dhe të transferueshme me akt mes të gjallësh si edhe për shkak të vdekjes së ortakut. Në rast bashkëpronësie të drejtat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues i përbashkët i emëruar sipas ligjit 1105 dhe 1106.
8. Në rast shitjeje të kuotave, ortakëve u takon e drejta e parablerjes.

Ortaku që ka ndërmend të shesë pjesërisht ose tërësisht kuotën e vet dhe të drejtat që i takojnë, duhet t'i njoftojë me shkrim me ane të një letre rekomande me kthim përgjigje ortakët e tjera dhe administratorët, në adresën që rezultojnë të regjistruar në regjistrin e ortakëve, duke përcaktuar informacionet personale te ortakut që shet, cmimin dhe kushtet e tjera të cedimit.

Ortakët që marin njoftimin duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes sipas kushteve, mënyrave dhe afateve më poshte:

- cdo ortak i interesuar për blerjen duhet t'i komunikojë ortakur ofrues një deklaratë për ushtrimin e parablerjes me letër rekomande të dërguar me postë jo me vonë se 30 ditë nga data e dergimit të ofertës për parablerje;
- në rast se kjo e drejtë ushtrohet nga më shume së një ortak, kuota dhe/ose të drejtat e ofruara i takojnë ortakëve të interesuar në proporcione kuotat e tyre ne zoterim;
- e drejta e parablerjes duhet ushtruar për totalin e kuotave dhe/ose të drejtave të ofruara; në rast ushtrimi të pjesshëm të këtyre të drejtave, si edhe në rast së asnjëri nga ortakët nuk dëshiron të blejë kuotat dhe/ose të drejtat e ofruara, ortaku ofrues është i lirë të transferojë kuotat dhe/ose të drejtat e ofruara blerësit të përcaktuar në ofertë.

Me qëllim parandalimin e dyshimeve në interpretim, theksohet se:

- në rast se një ose më shumë ortak vendos të heqë dorë nga e drejta e parablerjes, e drejta që i takon atij i shtohet në mënyrë proporcionale dhe automatikisht ortakëve të tjera që nuk kanë hequr dorë shprehimisht nga kjo e drejtë;
- në rast tranferimi të kuotave dhe/ose të drejtave me akt mes të gjallesh në shkelje të sa përshkruar më sipër, blerësi nuk do të ketë të gëzojë të drejten e votës dhe të drejtat e tjera administrative.

Kufizimet ndaj tranferimit te kuotave të parashikuara në këtë nen nuk zbatohen:

- Kur marresi eshte shoqeri kontrolluese e ceduesit ose shoqeri e kontrolluar ose e lidhur me kete te fundit ose e kontrolluar nga e njejta kompani meme.
  - kur transferimi kryhet ndaj shoqërive trust të autorizuara për ushtrimin e këtij aktiviteti sipas ligjit dhe/ose në rast ritransferimi nga ana e tyre ndaj përfituesve fillestarë, me anë të paraqites së mandatit të kalimit.
  - kur marrësi është bashkëshort ose i afërm në vijë direkte i ceduesit ose ortakut tjetër
9. E drejta e parablerjes është e rregulluar ne ligjin 2473, 2481 dhe 2497 te Kodit Civil dhe përashtohet në rast të zgjatjes së mandatit të shoqërisë me kusht që zgjatja të miratohet para skadimit.



Ortaku qe ka si qellim te ushtroje të drejten e terheqjes duhet të njoftojë administratorët nëpërmjet një letre rekomande e cila do të dergohet brenda 15 ditesh duke filluar nga momenti që:

- është regjistruar në regjistrin tregtar Vendimi i Ortakëve që lejon terheqjen;
- është transkriptuar në librin relativ vendimi i ortakeve ose i administratoreve që legjiimon te drejten e terheqjes

Ne rast të një vendimi nuk i nenshtrohen regjistrimit:

- Ortaku i terhequr i cili ka marre njoftimin që duhet ti dergohet administratoreve një leter rekomande dhe që është verifikuar një fakt që legjitimohet e drejta e tij e terheqjes.
- Ortaku i terhequr i cili është vene në dijeni të faktit që legjitimohet e drejta e tij e terheqjes.

E drejta e terheqjes ligjerisht e ushtruar, do të ketë efekt ne shoqeri nga dita e pare e muajit pasardhes deri ne fund te semestrit duke perfshire muajin që është pranuar letra e fundit rekomande e derguar nga ortaku i terhequr duke u bazuar ne kete ligj.

10. Për sa i perket percaktimit të shumes që i takon ortakut të dorehequr, për kushtet dhe menyren e pageses do të zbatohet neni 2473 i Kodit Civil, paragrafi i tretë dhe i katert.

11. Jane percaktuar si të drejta të ortakeve:

- 1- Aprovimi i bilancit dhe shpërndarja e fitimeve;
- 2- Zgjedhja dhe revokimi i administratoreve;
- 3- Zgjedhja e organit kontrollues ose e audituesit ligor;
- 4- Ndryshimet në aktin e themelimit;
- 5- Vendimin për te kryer operacione që perfshijnë një modifikim thelbesor të të drejtave të ortakeve, si dhe supozimin e aksioneve nga të cilat rrjedh per gjegjesia e pakufizuar për detyrimet e shoqerise së investuar;
- 6- Vendimet ne lidhje me shperberjen e parakohshme të shoqerisë;
- 7- Vendimet në lidhje me emërimin dhe revokimin e likuiduesve dhe ato që modifikojne rezolutat e marra ne zbatim te ligjit 2487, paragrafi i pare i Kodit Civil;
- 8- Autorizimi i marrjes së te mirave në natyre ose kredive nga ana e themeluesve ish artikulli 2465, paragrafi i dyte i Kodit Civil;

13. Vendimet në lidhje me çeshtjet e permendura ne pikat 4, 5, 6, 7, te paragrafit të mesiperm 11, duhet te miratohen me vendim të asamblese, si dhe vendimet para miratimit të marreveshjes së propozuar me kreditoret dhe kërkesen për pranimin e procedurës së administrimit, të kontrolluar në përputhje me nenin 152, 161, 187, te R.D numer 267 te vitit 1942.

14. Të gjitha vendimet që me ligj ose në bazë të statutit nuk duhet të miratohen me vendim asambleje, mund të merren ne baze të pelqimit të ortakeve të shprehur me shkrim.

Në këtë rast dokumentat e nenshkruara nga ortaket duhet të tregojne qartë objektin e vendimit.

Gjithashtu formularet e përshtatsherm dërgohen me faks ose email me kusht që në fastin e fundit abonimet të vendosen në formë dixhitale.



Midis nënshkrimit të parë dhe të fundit qoftë i mbledhur me një dokument të vetem ose me një shumice dokumentash nuk mund të kaloje një periudhe kohore që i kalon 30 dite.

Vendimi konsiderohet i përpunuar nese brenda afatit te siperpermendur arrijnë në kompani deklaratat e aprovimit të shumë ortakeve që përfaqesojne 51 % të kapitalit fillestar.

Të gjithë vendimet në forme jo asambleare duhet të transkriptohen dhe të ruhen sipas nenit 2478 te Kodit Civil.

15. Percaktimi i ortakeve të legjitimuar për te marrë pjese në vendimet jo asambleare është bere duke u referuar në daten e marreveshjes së parë, për sa kohe nderhyjne ndryshimet në strukturen e ortakeve ndërmjet datës se parë dhe të fundit te marrevëshjes, ortaku i ri mund te nënshkruaje vendimin ne vend të ortakut cedues duke bashkëlidhur vertetimin e administratoreve.

Prokura per të nenshkruar vendimet e ortakeve parashikuar në paragrafin 13 te sipërcituar duhet te lëshohet me shkrim.

16. Asambleja mbledhet ne seline e shoqerise ose ne një vend tjeter, per aq kohe sa eshte pjese e Bashkimit European.
17. Njoftimi duhet të permbate listen e çeshtjeve qe do të trajtohen, treguesin e dites, orën dhe vendin te vodosura për thirrjen e parë dhe të dytë të mundshme të takimit.


Ky takim duhet te dërgohet me mjete që garantojnë informacionin ne kohë për te interesuarin:

Mund te zgjidhet një nga këto mjete (ne menyre alternative ose kumulative):

- a) Leter rekomande e derguar te pakten 8 dite përpara takimit nepermjet sherbimit postar.
  - b) Letër e thjeshtë që duhet të kthehet nga të gjithë ortaket, brenda 5 ditesh nga data e cakuar për asamblene, me kopje te nënshkruar për pranim, me vodosjen e datës së térheqjes.
  - c) Mesazh me faks ose poste elektronike të marre nga të gjithë ortaket.
18. Ne mungesë të menyrave të mesiperme, asambleja konsiderohet e themeluar kur:

është prezantuar kapitali i plote i shoqerisë dhe te gjithë administratorët si dhe organi i kontrollit ose auditimit, nese përmenden, jane prezente, me deklaratë të presidentit te asamblese, rezultojnë të informuar nga mbledhja dhe nga argumentat që do te trajtohen dhe askush nuk del kunder trajtimit te argumenteve.

19. Mund të nderhyjnë ne asamble ata te cilët rezultojne të jene ortake ne datën e mbajtjes se vendimit.
20. Ortaket mund të perfaqesohen ne asamble edhe nga ata te cilët nuk janë ortakë.
21. Asambleja është kryesuar nga administratori i vetëm ose nga presidenti i keshillit ose administrimit, ose në mungese të tyre nga personi i caktuar nga të pranishmit.
22. Rezolutat e asamblesë duhet të shenohen ne procesverbal të nenshkruar nga presidenti dhe nëse është përmendur edhe nga sekretati i zgjedhur nga presidenti.
23. Akti i vendimit te asamblese qe modifikon aktin e themelimit redaktohet nga noteri.
24. Vendimet e asamblese, duke pasur si objekt ndryshimin e aktit të themelimit, kryerjen e operacioneve që perfshijnë një ndryshim thelbesor të qellimit të shoqerise, një ndryshim i rëndësishme i te drejtave



te ortakeve dhe shperberja e parakohshme e shoqerise duhet te miratohen me votë të favorshme nga shumë ortakë që përfaqesojnë shumicën e kapitalit të shoqërise.

Te gjitha rezolutat e tjera janë miratuar me prezencën e shume ortakëve që përfaqesojnë të pakten gjysmën e kapitalit të shoqerisë dhe votën e favorshme nga shumë ortakë që përfaqesojnë shumicën absolute të kapitalit të përfshire.

25. Rritja e kapitalit mund të implementohet edhe permes ofertës së të tretëve të te gjithë ose të një pjese të vleres se rritu meperjashtim te te drejtave te zgjedhjes qe u takojne ortakeve.

Vendimi i asamblese percakton te drejten e zgjedhjes ose disiplinon menyrat e nenshkrimit nga ana e ortakeve te tjere ose te te treteve nga pjesa e rritjes e mbetur e pazgjidhur.

Cdo njoftim i ortakeve që rezulton nga vendimet e sipërpërmendura duhet të bëhet nën kujdesin e administratoreve me postë rekomande.

26. Raporti i administratoreve dhe vezhgimet e organit të kontrollit ose te auditimit, sic është përmendor, nuk duhet të depozitohen në selinë qëndrore paraprakisht në asamble por të ilustrohen plotesisht

Në cdo rast administratorët gjatë asamblese duhet të japin llogari për faktet përkatese të ndodhura nga data e referimit të atij raporti ose në daten që mbahet asambleja.

27. Administrimi i shoqerise i është besuar një ose më shumë administratori në të kundërt një maksimumi prej nëntë, të zgjedhur nga ortaket me vendim të marrë sipas nenit 11 te mëparshëm.

Administratorët qëndrojne në detyrë sipas numrit të veprimeve të përcaktuar në aktin e emërimit të tyre ose me kohë të pacaktuar.

Administratorët janë gjithmonë të riemërueshëm dhe munden të mos jenë ortakë.

28. Kur administrimi i shoqerisë i është besuar shumë personave, vendimi i emërimit përcaktohet në menyrë alternative:

- a) nese administratorët përbejnë Këshillin e administrimit;
- b) nese perkundrazi administrimi i është besuar secilit administrator veçmas ose bashkerisht me një ose disa nga administratorët e tjere, edhe të cilësuar me emra.

Sipas pikes b) administratorët duhet gjithësesi të miratojnë në formë bordi vendimet të lidhura me hartimin e projektit të bilancit, për projektet e bashkuara ose të ndara dhe të rritjes së kapitalit të deleguar.

29. Këshilli zgjedh ndërmjet anetareve presidentin, kur këtë nuk arrijne ta bejne ortakët.

30. Këshilli i administrimit mblidhet edhe në vend të ndryshem nga selia e shoqërise me kusht te jete ne fushen e Bashkimit European, cdo herë që Presidenti e vlerëson të arsyeshme ose kur është bërë me kërkese me shkrim prej njërit nga anëtaret.

Njoftimi bëhet nga presidenti me një letër e cila duhet t'i dergohet të paktën pesë ditë përpara secilit anëtar të këshillit dhe Bordit te audituesve ose në rast urgjent, me telegram, fax ose mesazh postë elektronike e cila duhet të dërgohet të paktën dy ditë përpara.



Do të konsiderohen gjithësesi të vlefshme mbledhjet e këshillit administrativ edhe me difekt ne menyrën e njoftimit, kur të jenë prezantë të gjithë administratoret si dhe anëtaret e organit kontrollues ose auditimit, nëse përmenden.

31. Këshilli i administritmit është ndërtuar në mënyre të vlefshme me prezencë te shumicës së anëtarëve të saj.

Këshilli i administritmit emëron në menyrë të vlefshme me vota të shumicës absolute të të pranishmëve.

32. Mbledhjet e këshillit të administritmit janë të kryesuara nga presidenti ose në mungesë nga administratori i percaktuar nga të pranishmit.
33. Vendimet e këshillit duhet të shënohen në procesverbal të nënshkruar nga presidenti dhe nga sekretari. Vendimet e këshillit të administritmit mund të ndërmerrin në bazë të konsulencës së shkruar ose të konsensusit të shprehur me shkrim.
34. Vendimet duhet të janë ëe shkruara dhe të ruajtura sipas nenit 2478 te Kodit Civil.
35. Nese përgjate ushtrimit mungojnë një apo disa administratorë, ata që mbeten ose dhe njëri prej tyre, duhet t'i propozojnë urgjence ortakeve për të miratuar vendimet për emerimin e administratorëve të rinj.

Brenda 30 ditëve nga përfundimi i detyrës, për cfarëdo motivi, nuk veprohet si më sipër, vendimi mund të propozohet nga cilido prej anëtarave.

Ortakët do të sigurojnë këtë nominim duke respektuar formen fillestare të administritmit të përzgjedhur dhe kështu administratorët e nominuar do të shkarkohen së bashku me ata që janë në detyrë në kohën e emërimit të tyre.

36. Administratori i vetëm është përfaqësuesi kryesor i shoqërisë.

Në rastin e këshillit të administrit, përfaqësuesi kryesor i shoqërisë varet nga presidenti dhe nga administratorët e deleguar, nëse jane emruar.

Në rast të administrit të besuar shumë personave që nuk janë pjesë përbërëse e këshillit të administrit, përfaqësimi kryesor i shoqërisë varët nga secili administrator; ushtrimi i ketij pushteti, veçmas ose sëbashku, është përcaktuar në vendimin e emërimit.

Ne rast te kundert, ushtrimi i pushtetit të përfaqësimit konsiderohet i ndare.

37. Administratorët mund të emërojnë përfaqësues ose avokat për veprime të caktuara ose ~~kategori~~ aktesh.
38. Administratorit të vetem ose keshillit te administrit i ngarkohen të gjitha fuqitë për menaxhimin e zakonshëm ose të jashtëzakonshem të shoqërisë.

Keshilli i administrit, në limitet e parashikuara në nenin 2381 te Kodit Civil, mund të delegoje atributet e tij në çështjet e menaxhimit tërësisht ose pjesërisht, njerit ose disa administratorëve të vetëm, mundësish duke ia kaluar atyre titullin "administrator i deleguar", për qëllime të përfaqësimit të përgjithshëm të shoqërisë.



39. Kufizimet e fuqive të përfaqesimit nuk janë në dispozicion të tē tretëve, edhe pse janë publikuar, përvèc nesë vërtetohet se ata me dashje kane vepruar në dëm të shoqërisë.
40. Administratorëve i ngarkohet rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsyet e detyres.
41. Shoqëria mund tē emëroje një Organ Kontrolli ose një Auditues, që mund tē jetë edhe një shoqëri, përpara funksioneve dhe fuqive të percaktuara nga ligji.

Në rastet e parashikuara në nenin 2477 te Kodit Civil, emërimi i Organit kontrollues ose Auditues është detyrueshëm.

Organit i kontrollit, nese është e detyrueshme nga ligji ose e cituar, mund tē ndërtohet nga:

- Bordi i Audituesve, që përbehet nga tre anëtarë efektive dhe dy alternativë, të zgjedhur ndërmjet subjekteve në posedim të kërkjesave të parashikuara nga ligji; Presidenti i Kolegjit të auditoreve është emëruar nga ortakët;
- Audituesi i Veetem, i zgjedhur midis audituesve ligjorë të regjistruar në regjistrin përkates.

Organit i auditimit i kryer pervec kontrollit kontabël, në këtë rast duket te jetë integralisht i themeluar nga auditues ligjorë të regjistruar në regjistrat përkates.

- Për Organin e auditimit zbatohen ligjet materiale të kolegjit sindikal të parashikuara per shoqerinë aksionare.

Fuqitë dhe funksionet e organit kontrollues ose Auditues janë ato tē parashikuara nga ligji.

42. Veprimet e shoqerise mbyllen me date 31 dhjetor tē cdo viti.

Administratori i vetem ose administratoret procedojne ne përgatitjen e buxhetit dhe në prezantimin e tij brënda një afati kohor prej 120 ditësh nga mbyllja e vitit finanziar ose brënda 180 ditesh kur e kërkojnë nevoja tē veçanta të struktura dhe objektit tē shoqerisë.

43. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci i aprovuar, tē nxjera sic është parashikuar nga ligji, do tē shperndahen ose do tē lihen mënjanë sic është rënë dakort nga ortakët ne vendimin për miratimin e pasqyrave financiare.

44. Shoqëria mund tē marrë pagesa kapitale nga aksionarët ose nga një fond i humbur pa detyrim rimbursimi ose tē përcaktoje me ortakët, financime me detyrim rimbursimi sic parashikohet ne ligjin 2467 te Kodit Civil, edhe pa pageset interesash.

Shoqëria mundet gjithashtu tē fitoje fonde nga ortakët edhe me një arsyet tjeter, gjithmonë me detyrim rimbursimi, sipas rregulloreve në fuqi për mbledhjen e kursimeve nga ortaket.

45. Shoqëria mund tē leshojë letra me vlerë tē borxhit që mund tē nënshkruhen vetëm nga subjektet legitime.

Kompetanca për tē lëshuar letrat me vlerë tē borxhit i perket organit administrativ.

46. Ne rastet e parashikuara në ligj likuidimi i shoqerisë i besohet një likujduesi, i zgjedhur nga asambleja e ortakëve, me shumicën e parashikuar për ndryshimet në statut.



47. Përveç nëse zgjidhet ndryshe nga asambleja, likujduesit i perket fuqia për të plotësuar të gjitha aktet e nevojshme për kryerjen e likujdimit.
48. Të gjitha njoftimet ortakëve, ku ligji ose statuti aktual nuk parashikojnë një formë ose një menyrë specifike, duhet të bëhen në formë të shkruar dhe të dorezuara dorazi ose me postë rekomande ose me faks ose duke e dërguar me postë elektronike në adresat përkatëse të ortakeve, disa prej këtyre të fundit të njoftuara nga organi administrativ.

Ndryshimet e adresave duhet të bëhen në të njëjtën forme të parashikuar për njoftimet.

Njoftimet e administratorëve, audituesit, likujduesit dhe te shoqerisë duhet të bëhen me të njëjtat menya të sipërcituara, në adrese të shoqërise sic rezulton në regjistrin e shoqërive.

49. Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakeve dhe shoqerisë, administratorëve, likujduesve ose audituesve do t'i kalojnë gjykimit të një kolegji arbitral të përbërë nga tre anëtare, të emëruar nga presidenti i urdherit te tregetareve të Romës brënda një afati 30 ditor nga bërrja e pyetjes, e propozuar me kërkese të palës më te kujdeshshme.

Në rast të mungesës së caktimit të arbitrave brënda afatit, pyetja e ( ) mund ti propozohet, gjithmonë nga ana e palës më të kujdeshshme, kryetarit të gjykatës në rrëthim ku ndodhet selia e shoqërise.

Gjykata e arbitrazhit do të vendosë me shumicë votash, brënda 90 ditësh nga emërimi.

Kjo klauzolë e arbitrazhit është detyruese për shoqerinë dhe për të gjithe ortakët; është gjithashtu detyruese për administratorët, likujduesit dhe audituesit, relativisht në mosmarreveshjet e iniciuara prej tyre ose që janë vendosur kundër tyre.

Nuk mund të jenë objekt i klauzolës së arbitrazhit mosmarreveshjet për të cilat ligji parashikon ndërhyrjen e detyrueshme të administret publike.

Ndryshimet e aktit të themelimit, duhet të aprovojen nga ortakët që përfaqesojnë të paktën 2/3 e kapitalit të shoqerisë. Ortakët në mungesë kanë të drejtë që brënda 90 ditëve të ardhshme, të kryejnë të drejtën e térheqjes.

Gjykatës së arbitrazhit i janë transferuar gjithashtu mosmarreveshjet që kanë të bëjnë me vlefshmerinë e rezolutave të asamblese; në këtë rast gjykata do të gjykojë sipas të drejtës së saj dhe mund të disponojë me urdhër të pakthyeshëm, pezullimin e vlefshmërise së këtij vendimi.

Nënshkruar nga SPEDALE Roberto dhe RICCI Renzo; Paolo PISTILLI Noter.

Vula e Noterit



Kopje e informatizuar e njehsuar me origjinalin në letër, e firmosur sipas ligjit, që lëshohet për përdorim të regjistrimit të shoqërisë, në përputhje me nenin 22 të D.Lg. 82/2005.

Taksa e pullës e shlyer virtualisht sipas Dekretit 22/02/2007 .

Vule e rrumbullakët e Dhomës së Tregtisë Romë

23 Korrik 2021



APOSTILE  
(Konventa e Hagës 5 Tetor 1961)

**1. Shteti: REPUBLIKA E ITALISE**

**Ky akt publik**

**1. Shteti Itali**

**2. është firmosur nga:** Mazzeo Giovanina

a

**3. agjent në cilësinë e:** Nepunes

**4. mban vulën/pullën e:** Dhoma e Tregtise Industrise Artizanatit dhe Bujqesise Rome

VERTETOHET

**5. në Rome**


**6. Më 26/07/2021 10:52**

**7. nga Prefektura e Romes – Zyra qeveritare lokale Rome**

**8. me numër** 6444/2021

**9. vula/**

**10. Firma**  
Nepunesi i Deleguar  
Antonella Sergio  
(firma, vula)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



V2021053790430796463

DATE 13/08/2021

NR REP 6292/13

VËRTETIM PËRKTHIMI



Vërtetohet firma e përkthyeses zj. Anda Kaci, banuese në Tiranë, perkthyese e njojur nga Ministria e Drejtësise, e cila deklaron se ka përkthyer sa më sipër njëlloj me origjinalin nga italisht ne shqip dhe nënshkroi rregullisht para meje.

N O T E R E  
MAJLINDA DEMOLLARI

NOTERE  
Majlinda E. Demollari  
NIP/T: 2416060401  
TA: 0682061560

